

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI PËR ANKESA I AKP-së  
VEÇE ZA ŽALBE KAI-a**

GSK-AKP-A-61/11

Prishtinë, 1 mars 2012

Në çështjen civile të

V.S.

Ankuesi

*si përfaqësues ligjor*

M.J.S.

***Paraqitësja e kërkesës***

Kolegji për Ankesa të AKP-ës, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/88/2010, (shkresat e lëndës të regjistruara me numrin e AKP-ës KPA 47307) dhe KPCC/D/A/84/2010, (shkresat e lëndës të regjistruara me numrat e AKP-ës: KPA 47288, KPA 47289, KPA 47290, KPA 47292, KPA 47293, KPA 47294, KPA 47295, KPA 47296, KPA 47299, KPA 47301, KPA 47304, KPA 47305, KPA 47306, KPA 47308, KPA 47309, KPA 47310, KPA 47311, KPA 47312, KPA47313 , KPA47314 dhe KPA 47315), të datës 2 shtator 2011, pas seancës së mbajtur me datë 1 mars 2012 merr këtë:

## AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga V.S. me datë 27 maj 2011 dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-61/11 deri 82/11 janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-61/11.
- 2- Ankesat e paraqitura nga V.S. me datë 27 maj 2011 janë hedhë si të palejueshme.
- 3- Vërtetohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/88/2010, në pjesën që ka të bëjë me lëndën e regjistruar me numër KPA 47307 dhe KPCC/D/A/84/2010, në pjesën që ka të bëjë me lëndët e regjistruara me numrat KPA 47307, KPA 47288, KPA 47289, KPA 47290, KPA 47292, KPA 47293, KPA 47294, KPA 47295, KPA 47296, KPA 47299, KPA 47301, KPA 47304, KPA 47305, KPA 47306, KPA 47308, KPA 47309, KPA 47310, KPA 47311, KPA 47312, KPA47313 , KPA47314 dhe KPA 47315.
- 4- Shpenzimet e procedurës të përcaktuara në shumë prej 240 Euro (dyqindë e katërdjetë euro) do të mbulohen nga ankuesi, V.S. dhe do t'i paguhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës Gjykatës Supreme mbrenda afatit prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:

Më 28 nëntor 2007, M.J.S., duke vepruar si anëtare e familjes së ngushtë, në emër të vjehrrit të saj S.Đ.S., ka paraqitur 21 (njëzetënjë) kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), me të cilat, kërkonte vërtetimin e së drejtës së pronësisë mbi palujtshmëritë.

Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo i ka siguruar AKP-së dokumentacionin, si në vijim:

- 1- Çertifikatën e martesës së saj, Nr. 03-202-2003/V/808, e lëshuar me datë 15 dhjetor 2003, nga Komuna e Gjilanit, Republika e Serbisë, me seli në Vranjë;
- 2- Librezën tatimore të vjehrrit të saj, Nr. 10325, data e lëshimit nuk është e evidente, nga Komuna e Gjilanit;
- 3- Transkriptin nga Fleta Poseduese Nr. 77, Nr. 952-1/2007, e lëshuar me datë 14 Nëntor 2007 si e panënshkruar dhe e pavulosur, nga Instituti Republikan i Gjeodezisë – Shërbimi për Kadastër i Palujtshmërisë, Republika e Serbisë, Komuna e Gjilanit, Komuna Kadastrale e Parallovës; dhe
- 4- Leternjoftimi i saj, Nr. CP00007469, i lëshuar me datë 23 dhjetor 1999, nga Komuna e Gjilanit, Republika e Serbisë.

Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077, e lëshuar me datë 3 korrik 2008, nga Zyra Kadastrale Komunale e Gjilanit dhe Transkripti i Fletës Poseduese Nr. 77, i lëshuar nga Instituti Republikan i Gjeodezisë – Shërbimi për Kadastër i Palujtshmërisë, Republika e Serbisë, Komuna e Gjilanit, Komuna Kadastrale e Parallovës tregon se S.Đ.S. është pronar i këtyre palujtshmërive, siç vijon:

Nr. i lëndës së AKP-ës	Të dhënat mbi parcelen objekt kontesti	Dokumentet e paraqitura dhe të ofruara
Numri i lëndës KPA 47307	Ngastra kadastrale Nr. 4365, në vendin e quajtur “Jakovçane”, në sipërfaqe prej 0, 07, 78 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47288	Ngastra kadastrale Nr. 3790, në vendin e quajtur “Gashanci”, në sipërfaqe prej 0, 17, 23 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47289	Ngastra kadastrale Nr. 3820, në vendin e quajtur “Gashanci” në sipërfaqe prej 0, 16, 34 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.

Numri i lëndës KPA 47290	Ngastra kadastrale Nr. 3959, në vendin e quajtur “Gashanci”, në sipërfaqe prej 0, 21, 18 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47292	Ngastra kadastrale Nr. 3996, në vendin e quajtur “Çestak”, në sipërfaqe prej 0, 68, 97 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47293	Ngastra kadastrale Nr. 4017, në vendin e quajtur “Çestak”, në sipërfaqe prej 0, 40, 96 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 38322	Ngastra kadastrale Nr. 4018, në vendin e quajtur “Çestak”, në sipërfaqe prej 0, 17, 42 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47295	Ngastra kadastrale Nr. 4033, në vendin e quajtur “Kadinje Trnje”, në sipërfaqe prej 0, 21, 68 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47296	Ngastra kadastrale Nr. 4038, në vendin e quajtur “Kadinje Trnje”, në sipërfaqe prej 0, 9, 59 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47299	Ngastra kadastrale Nr. 4254, në vendin e quajtur “Prise”, në sipërfaqe prej 0, 18, 23 ha,	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.

	zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	
Numri i lëndës KPA 47301	Ngastra kadastrale Nr. 4260, në vendin e quajtur “Prise”, në sipërfaqe prej 0, 2, 51 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47304	Ngastra kadastrale Nr. 4356, në vendin e quajtur “Padina”, në sipërfaqe prej 0, 23, 93 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47305	Ngastra kadastrale Nr. 4357, në vendin e quajtur “Padina”, në sipërfaqe prej 0, 31, 11 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47306	Ngastra kadastrale Nr. 4358, në vendin e quajtur “Padina”, në sipërfaqe prej 0, 13, 21 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47308	Ngastra kadastrale Nr. 4366, në vendin e quajtur “Jakovćane”, në sipërfaqe prej 0, 7, 18 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47309	Ngastra kadastrale Nr. 4367, në vendin e quajtur “Livađa”, në sipërfaqe prej 0, 89, 73 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.

Numri i lëndës KPA 47310	Ngastra kadastrale Nr. 4368, në vendin e quajtur “Livada”, në sipërfaqe prej 0, 89, 73, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47311	Ngastra kadastrale Nr. 4369, në vendin e quajtur “Osoje”, në sipërfaqe prej 0, 24, 13 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47312	Ngastra kadastrale Nr. 4370, në vendin e quajtur “Osoje”, në sipërfaqe prej 0, 11, 42, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47313	Ngastra kadastrale Nr. 4371, në vendin e quajtur “Osoje”, në sipërfaqe prej 0, 56, 23 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47314	Ngastra kadastrale Nr. 4415, në vendin e quajtur “Stevin Zabelj”, në sipërfaqe prej 0, 30, 87 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.
Numri i lëndës KPA 47315	Ngastra kadastrale Nr. 4422, në vendin e quajtur “Markove Kruške”, në sipërfaqe prej 1, 15, 34 ha, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Transkripti nga Fleta Poseduese Nr. 77 dhe Çertifikata Mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Nr. UL-70403046-00077.

Në prill të vitit 2008 (KPA 47299: kullosë, KPA 47301: kopsht, KPA 47304: kullosë, KPA 47309: kullosë, KPA 47310: livadh, KPA 47311: arë dhe KPA 47312: kullosë) dhe nëntor (KPA 47305: mal, KPA 47306 livadh, KPA 47308: pemishte, KPA 47313: mal, KPA 47314: mal, KPA 47315: mal, KPA 47292: mal, KPA 47293: tokë jobujqësore, KPA 47294: mal, KPA 47295: livadh, KPA 47296:

mal, KPA 47307: dy shtëpi dhe oborr dhe KPA 47289: mal) e dhjetor të vitit 2009 (KPA 47290: mal, KPA 47288: pyll i dëmtuar), ekipi i njoftimit të AKP-ës, kishte shkuar në vendet ku gjendeshin ngastrat kadastrale objekt kontesti dhe kishte vendosur njoftimet, duke treguar se palujtshmëritë ishin objekt kontesti dhe se palët e interesuara do të duhej të paraqitnin përgjegjen e tyre mbrenda 30 ditësh. Asnjë nga palujtshmëritë nuk ishin të uzurpuara.

Me vonë në procedurë AKP-ja ka kontrolluar njoftimin dhe në bazë të “ortofoto dhe koordinatave GPS” ka gjetur se njoftimi ishte bërë në rregull.

Raportet verifikuese të AKP-ës, tregojnë se dokumentacioni i ofruar nga parashtruesja e kërkesës ka mundur të verifikohet. Gjatë zhvillimit të procedurës AKP-ja ka kontaktuar parashtruesen e kërkesës dhe është kërkuar nga ajo që të ofroj certifikatën e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore. Gjithashtu, ajo është pyetur nëse procedura e trashëgimisë ishte inicuar pas vdekjes së tij dhe nëse po të ofrohet vendimi mbi trashëgiminë. Paraqitëses së kërkesës i ishte dhënë afat kohor mbrenda së cilës ajo do të duhej të ofronte dokumentet e kërkuara.

Meqenëse askush nuk ishte përgjigjur në kërkesën e parashtruar sipas Nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut, e amendamentuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbrenda afatit të paraparë me të njëjtat dispozita ligjore, të gjitha kërkesat e parashtruara janë konsideruar si të pa-kontestuar.

Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimet KPKK/D/R/88/2010 dhe KPKK/D/A/84/2010, të datës 2 Shtator 2011, ka vendosur ti hudhë poshtë kërkesat (Neni 11.4 (a) i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50, të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Palujtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale dhe Nenin 8.6 (c) të Aneksit të III-të Udhëzimit Administrativ (UA) 2007/5, duke zbatuar Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/50, të amendamentuar nga po i njëjti ligj). Komisioni kishte konstatuar që paraqitësja e kërkesës nuk kishte zotësinë të përfaqësojë bartësin e të drejtës pronësore. Komisioni ka konstatuar se paraqitësja e kërkesës si re a bartësit të së drejtës pronësore sipas përkufizimit ligjor të nenit 1 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 nuk mund të konsiderohet anëtarë i familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore. Gjithashtu, paraqitësja e kërkesës nuk ka ofruar as autorizimin e ndonjë nga anëtarët e familjes së bartësit të së drejtës pronësore. Për më tepër, Komisioni ka theksuar se parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte vdekjen e bartësit të së drejtës pronësore.

Me datë 23 maj 2011 vendimet i janë dorëzuar V.S., bashkëshortit të paraqitëses së kërkesës dhe djalit të bartësit të të drejtave pronësore, meqë tanimë paraqitësja e kërkesës kishte ndërruar jetë qysh me 26 Nëntor 2008.

Më 27 maj 2011, V.S. (tani e tutje: ankuesi) me një shkresë ka parashtruar 21 ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke atakuar vendimin e KKKPK-ës në lidhje me lëndët KPA 47307, KPA 47288, KPA 47289, KPA 47290, KPA 47292, KPA 47293, KPA 47294, KPA 47295, KPA 47296, KPA 47299, KPA 47301, KPA 47304, KPA 47305, KPA 47306, KPA 47308, KPA 47309, KPA 47310, KPA 47311, KPA 47312, KPA47313 , KPA47314 dhe KPA 47315.

Ankuesi ka ushtruar ankesat për shkak të arsyeve të cilat edhe janë përfshirë në nenin 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, e amendamentuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079:

- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale; dhe
- Aplikimit të gabuar të shkeljes së ligjit material.

Ai ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, që vendimi i ankimuar ta hidhet për shkak të arsyeve të sipërtheksuara dhe që ankesa e tij të gjej zgjidhje pozitive në favorin e tij për lëndët e sipërpërmendura dhe që përfundimisht të vërtetohet se ai është pronar i palujtshmërive të pretenduara.

V.S., ka shpjeguar se parcelat në fjalë ishin pronësi e babait të tij vdekur me datë 22 nëntor 2000, dhe se paraqitja e kërkesave në lidhje me këto palujtshmëri ishte bërë nga gruaja e tij tanimë e ndjerë M.S.. Ai ka theksuar se që nga fillimi i luftës ai ka jetuar me gruan e tij M.S., fëmijët e tij dhe prindërit e tij deri në kohën kur familja e tij (gruaja e tij dhe fëmijët e tij) kanë lënë fshatin e tyre dhe Kosovën për shkak të luftës, përderisa prindërit e tij kanë mbetur të jetojnë në Paralovë. Ai ka kundërshtuar faktin se gruas së tij i nevojitet autorizim i posaçëm.

Me 24 dhjetor 2010, ankuesi V.S., me qëllim të provimit të lidhjes familjare në mes të tij dhe paraqitëses së kërkesave - gruas së tij tanimë të ndjerë – dhe lidhjes familjare me bartësin e së drejtës pronësore – babain e tij - i kishte ofruar dokumentacionin, si vijon:

- Çertifikatën e lindjes së tij, e lëshuar me datë 7 dhjetor 2009, nga Komuna e Gjilanit, Republika e Serbisë;



- Çertifikatën e martesës së tij me M.S. (mbiemri i vajzërisë: M.), e lëshuar me datë 8 dhjetor 2008 nga Komuna e Gjilanit, Republika e Serbisë; dhe
- Çertifikatën e vdekjes së M.S., e lëshuar me datë 2 dhjetor 2008 në Nish, Republika e Serbisë.

Gjykata Supreme i ka bashkuar ankesat.

### **Arsyetimi ligjor:**

#### **Bashkimi i ankesave:**

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-61/11 deri 82/11 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-61/11.

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parshohin mundësinë që gjykata t'i bashkojë gjykimet me vendim me qëllim që t'i trajtoj bashkarisht ato nëse ky bashkim kontribon në efektshmërinë e procedurës.

Në lëndët në fjalë, ankuesi ka parashtruar ankesat e tij në një leter-shkresë, ku në mënyrë shprehimore ka cekë lëndët për të cilat ai ushtron ankesë. Nga kjo Gjykata konstaton se ankuesi në mënyrë të heshtur ka dhënë pëlqimin e tij për bashkimin e lëndëve, ashtu siq është paraparë me nenin 408.3 të LPK-ës. Më tutje Gjykata Supreme e Kosovës vëren se faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë plotësisht të njëjta në të 21 (njëzetënjë) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cila pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Meqë të gjitha elementet e lëndës janë të njëjta

përveç parcelave, do të ishte më efikase nëse bashkohen ankesat dhe ato të ekzaminohen në një aktgjykim të vetëm.

### **Pranueshmëria e ankesave:**

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIKU-t 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.

Në rastin konkret meqë vendimet e KKPK-ës i janë dorëzuar ankuesit me datë 23 maj 2011 dhe ankesat janë parashtruar nga ai me datë 27 maj 2011, e që është më pak se 30 ditë nga dita e pranimit të njoftimit mbi vendimet e KKPK-së.

Ankesat, sidoqoftë, nuk janë parashtruar nga (tani e ndjera) paraqitësja e kërkesës, kërkesat e së cilës janë hedhë poshtë, por nga bashkëshorti i saj. Ankesat e tija do të ishin të pranueshme nëse ai do të ishte pasardhës ligjor i paraqitëses së kërkesës, posaqërisht si trashëgimtar. Përndryshe – meqë ai nuk ka qenë palë në procedurën para KKPK-ës – ai nuk do të ketë të drejtë në ankesë (Neni 10.2 i Rregullores 2006/50 së UNMIK-ut së sipërmendur, gjithashtu shih Nenin 176.1 të LPK-ës). Gjykata Supreme nuk disponon ndonjë fakt që do të i ishte referuar suksesionit ligjor. Fakti i vetëm se ankuesi ishte burri i paraqitëses së kërkesës nuk e bënë atë trashëgimtar ligjor. Pyetja nëse ankuesi është trashëgimtar ligjor i paraqitëses së kërkesës, sidoqoftë, mund të mbetet pa përgjigje. Meqenëse ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të domosdoshme për të provuar se paraqitësja e kërkesave ka pasë të drejtën e paraqitjes së kërkesës, ankesa nuk është e bazuar.

### **Meritat:**

#### **1- Çështjet e statusit civil (pranueshmëria e kërkesës)**

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se në bazë të dokumentacionit të siguruar nga paraqitësja e kërkesës dhe raporteve të verifikimit të Sekretariatit Ekzekutiv, Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të duhur se parcelat, objekt të kërkesave, i kanë takuar S.Đ.S..

Sidoqoftë, Gjykata Supreme konsideron dhe është e të njëjtit mendim sikur edhe Komisioni se M.S. si re e bartësit të së drejtës pronësore nuk mund të paraqesë kërkesat si një “anëtarë i familjes së ngushtë”. Përkufizimi ligjor në Nenin 1 të UD 2007/5 i cili thotë **“anëtar i familjes do të thotë bashkëshorti apo bashkëshortja, fëmijët dhe personat e tjerë, të cilët është i obliguar t’i**

*përkrahë bartësi i të drejtës pronësore në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta përkrahin bartësi e së drejtës pronësore në përputhje me ligjin në fuqi, pavarësisht nëse ai person ka banuar në atë pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore apo jo”.* Sipas këtij definimi, rejat nuk gjinden në mesin e anëtarëve të familjes së ngushtë dhe se nuk ekziston obligimi ligjor se rejat që të ndihmojnë vjehrrit e tyre. Deklarata e ankuesit, se ai kishte jetuar së bashku me gruan e tij, fëmijët e tij dhe prindërit e tij deri kur ai, gruaja e tij dhe fëmijët kishte lëshuar Kosovën përderisa prindërit kanë qëndruar, nuk ndryshon opinionin ligjor të Gjykatës.

Si rezultat i kësaj, paraqitësja e kërkesës do të kishte të drejtë të parashtroj kërkesën vetëm nëse do të posedonte autorizimin e bartësit të të drejtës pronësore ose anëtarit të familjes së ngushtë të bartësit të së drejtës pronësore ashtu siq është parashikuar sipas nenit 5.2 të të njejtit Udhëzim Administrativ, që cek “ ..... **Paraqitësi (ja) mund të përfaqësohet nga personi fizik i autorizuar me autorizim të rregullt dhe valid .....** “. Sidoqoftë, paraqitësja e kërkesës nuk ka ofruar autorizimin e nevojshëm, edhe pse disa herë AKP-ja i kishte kërkuar asaj këtë. Për këtë arsye vendimi i KKPK-ës është i drejtë.

Gjykata Supreme gjithashtu ka sqaruar çështjen nëse fakti, se ankuesi, djali i bartësit të të drejtës pronësore, tani ka ushtruar ankesën, do të mund të interpretohej si dhënje e autorizimit.

Për më tepër, Gjykata Supreme ka marrë në konsideratë çështjen nëse autorizimi i domosdoshëm, i cili nuk është dorëzuar në instancën e parë (procedura para Komisionit) do të mund të parashtrohej dhe të mirrej në konsideratë nga Gjykata në instancën e dytë. Përfundimisht, sidoqoftë, Gjykata nuk ka nevojë t’i përgjigjet e këtyre pyetjeve, për këto asrye:

KKPK-ja në vendimin e tij me të drejtë ka deklaruar, se paraqitësja e kërkesës nuk ka qenë në gjendje të ofroj certifikatën e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore. Ankuesi – i pretenduar – si trashëgimtar ligjor i paraqitëses së kërkesës gjithashtu duhet të ofroj certifikatën e vdekjes së bartësit të së drejtës pronësore. Sidoqoftë, në deklaratën e tij të datës 24 dhjetor 2010, ankuesi deklaroi se ai nuk është në gjendje të ofroj certifikatën e babait. Si datë e vdekjes së babait të tij ai përmend 22 nëntorin 2000. Edhe kjo nuk është e mjaftueshme të provoj vdekjen e babait të tij – bartësit të së drejtës pronësore.

Gjykata dëshiron të shton se dokumentet shtesë të paraqitura nga ankuesi, siç është çertifikata e vdekjes së paraqitësit të kërkesës, çertifikata e martesës e tij dhe paraqitëses së kërkesës nuk janë të përshtatshme për të provuar të drejtën e ankuesit për të kërkuar të drejtat e bartësit të së drejtës pronës.

## **2- Kërkesa e paraqitur nga ankuesi**

Ankuesi në të vërtetë në ankesat e tij ka formuluar një kërkesë të re të tij, duke kërkuar nga Gjykata Supreme që tanimë atij t'i njihet e drejta e pronësisë mbi palujtshmëritë në fjalë.

Paraqitja e kërkesës shtesë do të thotë ndryshimi i kërkesës. Sipas neneve 258.1 dhe 258.2 të Ligjit 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, paraqitësi i kërkesës mund ta ndryshoj kërkesën jo më vonë se përfundimi i shqyrtimit gjyqësor në nivelin e shkallës së parë. Në rast se nuk ka shqyrtim në shkallën e parë, është e qartë se ndryshimi i kërkesës duhet të bëhet para seancës këshilluese në mënyrë që të mund të shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë. Megjithatë, nuk mund të bëhet për herë të parë pranë gjykatës së shkallës së dytë.

Si rezultat, kjo kërkesë edhe hidhet poshtë.

Rezultatitivist, bazuar mbi arsyetimin ligjor të mësipërm, vendimi i KPPK-ës duhet të vërtetohet.

Ky vendim nuk prejjudikon të drejtën e ankuesit të kërkoj vërtetimin e të drejtës pronësore mbi palujtshmëritë objekt kontesti, para gjykatës kompetende vendore.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Sipas nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit Ekzekutiv dhe Komisionit.

Sidoqoftë, në lirim i tillë nuk parashihet për procedurat pranë Gjykatës Supreme.

Si rrjedhojë, regjimi normal i tarifave të gjykatës siç është paraparë me Ligjin mbi Tarifat e Gjykatave (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe sipas UD-së Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e tarifave të gjykatave janë të aplikueshme për procedurat pranë Gjykatës Supreme.

Prandaj, tarifatat në vijim janë të aplikueshme në këtë procedurë ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UD-së 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UD-së 2008/2), duke e marrë parasysh se vlera e gjithmbarshme e kësaj prone në fjalë e përbërë nga sipërfaqja prej 0. 14. 67 ha e livadheve dhe 0. 64. 08 ha e pyjeve në Komunën Kadastrale Zebincë dhe sipërfaqja prej 3.38.60 ha si tokë e kultivuar, 0. 60. 10 ha si livadhe dhe 6. 60. 21 ha e pyjeve në Komunën Kadastrale Parallovë do të mund të kalkulohej në mënyrë të arsyeshme si vlerë në shumë prej 32.000 €: 50 € + 0.5% e 32.000 = 210 €

Këto shpenzime gjyqësore do të mbulohen nga ankuesi i cili e humb lëndën.

Sipas nenit 46 të Ligjit Mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati kohor i pagimit të taksave nga individ i cili ka vendbanim ose vendqëndrim jashtë nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij.

### **Këshilla ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i zbatueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

**Nënshkruar nga: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit e EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Regjistruer i EULEX-it**